



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1439 Prot.

Tiranë, më 20 / 09 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 126 , Datë 20 / 09 / 2019**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.30 Regj., datë 01.04.2019, të Lëvizjes Rinore Egjiptiane Rome (LRER), kundër Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime (UK) Elbasan dhe Bashkisë Elbasan, me pretendim diskriminimin për shkak të “racës<sup>1</sup>”, “gjendjes ekonomike<sup>2</sup>” dhe “vendbanimit<sup>3</sup>”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>4</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Përmes ankesës së sjellë pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome (LRER) ka përcjellë shqetësimet e banorëve të lagjes “Dyli Haxhire”, rruga “Ilir Shehu”, të cilët, pjesa më e madhe i përkasin komunitetit egjiptian me rreth 80 familje.

<sup>1</sup> Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, ankuesit kanë hequr dorë nga pretendimi për diskriminim për këtë shkak.

<sup>2</sup> Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, ankuesit kanë hequr dorë nga pretendimi për diskriminim për këtë shkak.

<sup>3</sup> Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, ankuesit kanë shtuar këtë shkak.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në ankesën e tyre bëhet prezente problematika e mungesës së furnizimit me ujë, e cila është një problematikë që ekziston prej vitesh. Momentalisht aty ekziston një tub i cili qëndron mbi sipërfaqen e tokës, i vendosur për të furnizuar përkohësisht familjet me ujë. Gjatë dy viteve të fundit mbi 50 familje nuk furnizohen me ujë nga ky tub, i cili është jashtë standarteve dhe krijon lehtësisht mundësi abuzimi. Disa prej banorëve janë shprehur se kanë shkëputur marrëdhëniet kontraktore me UK Elbasan për shkak të mungesës së ujit prej kohësh dhe se nevojat familjare i plotësojnë duke mbushur ujë në disa dalje të tubit në fillim të rrugës, gjë e cila bëhet shkak për lindjen e konflikteve të vazhdueshme midis banorëve. Ata shprehen se janë të gatshëm të lidhin akt-marrëveshje me UK Elbasan nëse furnizohen me ujë të pijshëm nëpër banesat e tyre.

LRER shprehet se këtë problematikë e kanë adresuar disa herë pranë UK Elbasan dhe Bashkisë Elbasan, por ende situata mbetet shqetësuese dhe e pa zgjidhur për banorët e kësaj lagjeje.

Në përfundim të ankesës së tyre, banorët e lagjes “Dyli Haxhire”, rruga “Ilir Shehu”, kërkojnë nga ana e Bashkisë Elbasan dhe UK sh.a Elbasan, të marrin masat e nevojshme për të garantuar që dhe ata si banorët e lagjeve të tjera jo rome/egjiptiane, të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa dallim e diskriminim për shkak të racës apo gjendjes ekonomike të tyre.

Referuar Vendimit nr.3754, datë 11.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, shoqata LRER është regjistruar si person juridik dhe ka në fokus të veprimtarisë së saj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, gjë që e legjitimon atë “*locus standi*” për të paraqitur ankesë në emër të komunitetit egjiptian për çdo pretendim për diskriminim për shkak të racës.

Në vijim të komunikimit me Zyrën e KMD-së, LRER , nëpërmjet e-mailit<sup>5</sup> ka kërkuar që shqyrtimi i ankesës së tyre të fokusohet tek diskriminimi i banorëve për shkak të vendbanimit të tyre, duke hequr dorë nga dy shkaqet e tjera të pretenduara fillimisht, raca dhe gjendja ekonomike.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>6</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve

<sup>5</sup> E-mail i datës 26.08.2019 i LRER drejtuar KMD-së.

<sup>6</sup> Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

*publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.518/1 prot., datë 09.04.2019 i është kërkuar informacion Bashkisë së Elbasanit dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sh.a Elbasan (UKE), lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Nëpërmjet shkresës me nr.1044/1 prot., datë 23.04.2019, UK sh. a Elbasan ka informuar Komisionerin se, zona në fjalë i është nënshtruar një investimi të pjesshëm nga ana e tyre, për rregullimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për këta banorë.

UKE sh. a bën me dije se kjo zonë (rruga “Ilir Shehu”) është një zonë e cila ka komunitet të përzier, pra jo vetëm romë dhe egjiptianë dhe nuk ka diskriminim të tyre për shkak të racës. Nga ana tjetër, kjo zonë paraqet vështirësi, pasi një pjesë e madhe e banorëve kanë bërë ndërtime informale, pa studim urbanistik, mbi kuotën e furnizimit normal të ujësjellësit dhe se debia në këtë zonë ndaj UKE sh.a shkon në 60 milionë lekë, çka përbën një shumë të konsiderueshme duke vënë në vështirësi Shoqërinë për të bërë investime në këtë zonë.

UKE sh.a citon në shpjegimet e veta se, pavarësisht këtyre vështirësive, brenda mundësive të tyre financiare të deritanishme, për rritjen e efektivitetit të furnizimit me ujë të pijshëm, edhe të banorëve që jetojnë në pjesën e sipërme të kësaj lagjeje, janë në proces zëvendësimi të pompës ekzistuese me një pompë tjetër, me kapacitete më të mëdha nga pompa aktuale, dhe se prerjet e paligjshme, do ndikojnë pozitivisht në rritjen e furnizimit me ujë për atë pjesë të lagjes.

Po ashtu, UKE sh.a informon se një pjesë e banorëve të kësaj lagjeje ishin lidhur në të dy tubacionet që furnizojnë këtë zonë dhe ndaj tyre janë bërë prerje të linjave individuale, gjë që do të rrisë presionin për zonën e sipërme.

UKE sh.a thekson se, të gjithë hapat e ndërmarrë prej tyre, janë brenda mundësive aktuale financiare të Shoqërisë. Ndërsa, për një zgjidhje më afatgjatë, Shoqëria ka përgatitur një projekt për të cilin ka kërkuar financim nga ana e donatorëve financiarë.

Shoqëria ka sqaruar se lidhja e abonentëve në linjat e reja, bazohet në Rregulloren e Brendshme të UKE sh.a, në Rregulloret në fuqi nga ERRU apo VKM respektive, lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm<sup>7</sup>. Ata theksojnë faktin se trajtojnë si të barabartë përballë ligjit çdo konsumator dhe abonent, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike apo përkatësisë komunitare, gjendjes ekonomike etj.

- Nga ana e Bashkisë së Elbasanit nuk u sollën parashtrime lidhur me sa kërkoi Komisioneri, referuar problematikës së ngritur nga LRER<sup>8</sup>.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje, Komisioneri me datë 20.06.2019<sup>9</sup> zhvilloi një séance dëgjimore.

Në seancë u paraqitën përfaqësues të palëve në proces<sup>10</sup>: LRER dhe UKE. Nga ana e Bashkisë Elbasan nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Përfaqësuesit e UKE, në thelb u qëndruan të njëjtave parashtrime të sjella nëpërmjet shkresës me nr.1044/1 prot., datë 23.04.2019 dhe theksuan faktin se ata kanë realizuar ndërrimin e pompës për rrugën "Ilir Shehu", por dhe aktualisht banorët kanë kryer ndërhyrje të paligjshme përgjatë këtij tubacioni i cili nuk mundëson kështu furnizimin me ujë të pjesës së sipërme të saj, pasi ulet presioni i ujit.

Referuar procesverbalit të mbajtur gjatë seancës, u ra dakort që UKE, të depozitonte në cilësi prove në vijim, dokumentacion provues lidhur me projektin që kjo Shoqëri kishte hartuar lidhur me vendosjen e nje depozite në pjesën e sipërme të rrugës.

LRER pretenduan se nuk janë ndërmarrë masa konkrete efektive, nga ana e UKE dhe Bashkisë Elbasan, përse kohë ata sërisht nuk furnizohen me ujë, pavarësisht përpjekjeve të tyre nëpërmjet ndërrimit të një pompe uji.

---

<sup>7</sup> a) Abonentët nuk duhet të jenë debitorë ndaj UKE sh.a.

b) Në rast se abonenti është debitor, para se të kryhet lidhja e ujit në tubacionin e ri, duhet të paraqitet pranë Zyrave qendrore të UKE sh.a, për të lidhur Akt-Marrëveshjen për shlyerjen e debisë me këste (sipas rregullave në fuqi)

c) Në çastin e lidhjes së ujit të pijshëm në tubacionin e ri, bëhet dhe vendosja e ujëmatësit sipas standarteve CE, mbështetur në Kodin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve.

d) Shpenzimet e blerjes së ujëmatësit përballohen nga vetë abonenti, mbështetur në Kontratën për Shërbime Ujësjellës-Kanalizime.

<sup>8</sup> Referuar kuponit "Lajmërim-marrje" të Shërbimit Postar, rezulton se Bashkia Elbasan ka marrë dijani për shkresën e KMD-së që me datë 11.04.2019.

<sup>9</sup> Referuar njoftimit për senacën dëgjimore nëpërmjet shkresës me nr..518/3 prot., date 10.06.2019 të Komisionerit.

<sup>10</sup> Referuar akteve shkresore të depozituara gjatë seancës dëgjimore.

3. Nëpërmjet shkresës me nr.518/4 prot., datë 19.07.2019 Komisioneri i ka kërkuar UKE dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore.

4. Në vijim të procedurës së ndjekur për shqyrtimin e ankesës, si dhe në zbatim të Urdhërit nr.137, datë 05.08.2019 të Komisionerit, me datë 08.08.2019, inspektorët e KMD-së realizuan këqyrjen dhe vlerësimin në terren të situatës së banorëve të rrugës “Ilir Shehu”. Gjatë inspektimit ishin të pranishëm përfaqësues të LRER, UKE dhe banorë të lagjes<sup>11</sup>.

Gjatë inspektimit u konstatuan ndërhyrje të shumta në tubacionin që realizon furnizimin me ujë të pjesës së sipërme të kësaj rruge. Përfaqësuesit e UKE theksuan faktin që në vijim do të dërgonin kopje të projektit të miratuar që do mundësojë dhe zgjidhjen përfundimtare dhe të përhershme të kësaj problematike.

UKE ka dërguar<sup>12</sup> në cilësi prove pjesë të dokumentit “Preventiv i riparë sipas manualeve të ndërtimit 2015, me objekt: “Rikonstruksion Ujësjiellësi në rrugën “Kongresi i Përmetit”, NSHU, Njësia Administrative nr.4, Bashkia Elbasan-viti 2019”, si dhe foto të planimetrisë së rikonstruksionit të Ujësjiellësit në këtë rrugë. Theksojmë faktin se nuk është specifikuar asnjë datë për fillimin apo përfundimin e këtij projekti.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.**

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, është fakt i provuar dhe i pranuar nga të dyja palët në proces që:

*Së pari*, në këtë lagje ka mungesë të ujit të pijshëm prej shumë vitesh dhe ende nuk është gjetur zgjidhja e duhur për furnizimin e banorëve. Banorët janë detyruar të sigurojnë ujin e pijshëm duke e blerë ose duke e mbushur tek banorët që banojnë në pjesën e poshtme të rrugës, në ato raste kur ka patur mirëkuptim prej tyre.

*Së dyti*, mbetet ende e pazgjidhur problematika e ndërhyrjeve të paligjshme në tubacionin e furnizimit me ujë përgjatë gjithë kësaj rruge, fakt ky i pranuar edhe nga UKE sh.a.

---

<sup>11</sup> Referuar të dhënave të mbajtur në procesverbalin e inspektimit.

<sup>12</sup> Nëpërmjet e-mailit.

Së treti, megjithë masat e ndërmarra nga ana e UKE sh.a për ndërrimin e pompës së ujit, duke vendosur një pompë të re dhe më të fuqishme, sërisht ajo ka rezultuar jo efektive pasi nuk ka arritur të realizojë furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të pjesës së sipërme të kësaj rruge. Lidhur me sa mësipër, Komisioneri, vlerëson se Bashkia Elbasan, si autoriteti shtetëror përgjegjës nuk mund të justifikojë mosveprimin e saj për furnizimin me ujë të pijshëm, pavarësisht faktit se ky shërbim realizohet drejtëpërdrejtë nga UKE sh.a, e cila është Shoqëri në varësi të saj.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast UKE sh.a dhe Bashkisë Elbasan. Pra, në këtë rast ata, duhet të provonin se subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme se banorët e tjerë të pjesës së poshtme të rrugës “Irir Shehu”.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Po ashtu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe u janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Si UKE sh.a dhe Bashkia Elbasan, dështuan të provonin para Komisionerit se kanë bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situatë jetike për banorët e rrugës “Irir Shehu”.

Në këto kushte, referuar informacionit të administruar, Bashkia Elbasan nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmarrë për furnizimin me ujë të pijshëm për këta banorë.

UKE sh.a pavarësisht ndërmarrjes pozitive për ndërrimin e pompës së ujit, ka dështuar të furnizojë efektivisht me ujë banorët e kësaj rruge, si dhe të informojë Komisionerin, lidhur me masat dhe afatet konkrete afatshkurtra, afatmesme apo afatgjata të projektit të cituar prej tyre, si zgjidhje efektive të kësaj problematike. Pretendimi i UKE sh.a lidhur me zbatimin e këtij projekti mbetet më së shumti i karakterit deklarativ sesa i dokumentuar dhe argumentuar duke saktësuar data apo periudha konkrete për realizimin e tij.

Në analizë të sa më sipër, mungesa e ujit të pijshëm është fakt i njohur prej kohësh, për të cilin Bashkia Elbasan dhe UKE sh.a nuk kanë marrë asnjë masë efektive për t'i dhënë zgjidhje efektive kësaj situatë. Mospërmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, nga ana e Bashkisë Elbasan dhe UKE sh.a, vendos në pozita të pabarabarta ankuesit e pjesës së sipërme të rrugës "Ilir Shehu" me banorët e tjerë të kësaj rruge, të cilët banojnë në pjesën e poshtme të saj, pikërisht për shkak të mosfurnizimit të tyre me ujë, si rezultat i terrenit në cilin ndodhen banesat e tyre.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>13</sup> të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në "shkakun e mbrojtur". Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues mbartin shkakun e pretenduar, atë të vendbanimit. Subjektet ankues, banorët e lagjes "Dyli Haxhire", rruga "Ilir Shehu", pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e

<sup>13</sup> Neni 2: "Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim."

Bashkisë Elbasan dhe UKE, pikërisht për shkak të vendbanimit të tyre, i cili rezulton të jetë në pjesën e sipërme të kësaj rruge, në një terren të ngritur, gjë që pamundëson furnizimin me ujë të pijshëm për shkak të mosfunksionimit të pompës së ujit.

*“Vendbanimi” është shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Theksojmë faktin që ankuesit kanë hequr dorë nga pretendimi për diskriminim për shkak të racës apo gjendjes ekonomike, pasi në këtë rrugë banojnë dhe qytetarë që nuk janë pjesëtarë të komunitetit rom dhe egjiptianë.

#### **A. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Për të vërtetuar se ndaj subjekteve ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Elbasan dhe UKE sh.a, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar nga ankuesit, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>14</sup> dhe trajtimit të pafavorshëm të tyre.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Elbasan dhe UKE sh.a<sup>15</sup>, ishin në dijeni të problematikave të ngritura nga LRER në emër të banorëve të rrugës “Ilir Shehu”, dhe se kishin dështuar deri më tani të ndërmerren masa efektive për përmirësimin apo rregullimin e situatës, e cila pranohet edhe prej tyre.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

---

<sup>14</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>15</sup> Referuar kërkesave të LRER drejtuar këtyre Institucioneve, të cilat ndodhen në dosjen e ankuesve, depozituar pranë KMD-së.



Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta<sup>16</sup> si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Dinjteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese<sup>17</sup>. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, "Ndalimi i diskriminimit", përcakton se: "*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*".

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë<sup>18</sup>, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: "*...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme...*".

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm<sup>19</sup> dhe jurisprudencës së

---

<sup>16</sup> Neni 18 i Kushtetutës ka sanksionuar se: "*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive*".

<sup>17</sup> Në Preambulën e Kushtetutës deklarohet: "*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë*".

<sup>18</sup> Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

<sup>19</sup> Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

GJEDNJ-ja në disa raste ka konkluduar se kushtet e mjerueshme të jetesës mund të konsiderohen si trajtim çnjerëzor dhe degradues<sup>20</sup>. Gjykata është shprehur se mungesa e aksesit për ujë të pijshëm dhe higjenë çon në trajtim çnjerëzor dhe degradues të njeriut.

Referuar rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010, në të cilën Asambleja njohu të drejtën për ujë të pijshëm të pastër dhe të sigurt dhe për kanalizime si një të drejtë të njeriut, e cila është thelbësore për gëzimin e plotë të jetës dhe të të gjitha të drejtave të njeriut, theksohet se uji i pijshëm është jetësor në realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Kjo rezolutë shton trysinë mbi përgjegjësinë politike të shteteve për t'u garantuar qytetarëve të drejtën elementare për ujë të pijshëm.

Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm, mosmarrja e masave për zgjidhje efektive të situatës nga ana e UKE sh.a dhe Bashkisë Elbasan, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues.

Vazhdimi i kësaj situatë prej vitesh, pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia Elbasan përmes mosveprimit të saj, ka neglizhuar të përmbushë detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Ndërsa, UKE sh.a pavarësisht ndërhyrjes positive të ndërmarrë prej saj përmes ndërrimit të pompës furnizuese, nuk ka arritur të zgjidhë apo përmirësojë efektivisht problematikën e furnizimit me ujë të pijshëm për këta banorë.

Referuar nenit 23, pikat 1 dhe 2, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Referuar nenit 23, pika 4, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për prodhimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.

Nuk mund të pretendohet se është përmbushur detyrimi ligjor për furnizimin me ujë të pijshëm vetëm për faktin se ekziston rrjeti fizik i linjave të ujit. Furnizimi me ujë nuk përfshin vetëm ekzistencën e rrjetit fizik të furnizimit me ujë, por aksesin e qytetarëve në ujin e pijshëm; në

---

<sup>20</sup> Çështja “Neshkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë” dhe “Jordan Petrov kundër Bullgarisë” dhe “Halil Adem kundër Bullgarisë”.

mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, si për përdorimin personal, ashtu edhe për atë shtëpiak.

Kuadri ligjor ka mirëpërcaktuar se është detyrë e përgjegjësi e UK-së (që është në varësi të pushtetit vendor) të sigurojë furnizimin me ujë të pijshëm dhe të shëndetshëm. UK ka detyrim të shtrojë linjat e furnizimit, të vendosë matës në familjet konsumatore dhe të bëjë furnizimin me ujë të pijshëm.

Rregullorja “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a””, ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar marrëdhënien ligjore ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UK sh.a., që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, pra Pushteteve Vendore në përbërje të zonës së shërbimit.

Nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë, rregullorja synon, ndër të tjera, edhe sigurimin e një furnizimi me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi.

Pika 1.2 e kësaj rregulloreje ka përcaktuar se, në përputhje me detyrimin ligjor për të garantuar furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe konsumatorëve të tjerë, si dhe largimin e kontrolluar dhe me rregull të ujërave të ndotura, Bashkia ngarkon për funksionim dhe mirëmbajtje një shoqëri publike të licensuar nga Enti Rregullator Kombëtar i Ujit për këto shërbime.

Bashkitë që posedojnë 100% aksione të kësaj shoqërie, me anë të asamblesë së aksionarëve realizojnë vendimmarrjet e rëndësishme për UK sh.a., përcaktojnë natyrën dhe qëllimin e ndërmarrjes si edhe datën e zbatimit, zgjerimin ose riorganizimin e saj.

UK sh.a. përfaqëson institucionin funksional dhe ekzekutiv që vepron në emër të Bashkisë që ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në zonën e shërbimit.

Objekti i UK sh.a. në zonën e shërbimit për ujin e pijshëm është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitja e tij,
- Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm,
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve,
- Trajtimi i ujit nëse burimi është sipërfaqësor.

Lidhur me sa mësipër, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i KB (CESCR), kërkon që shtetet të angazhohen për ngritjen e sistemeve për shpërndarjen e ujit, që shmangin përjashtimin e grupeve të caktuara të popullsisë, e veçanërisht ato grupe të mbrojtura nga parimet e mosdiskriminimit.

Sipas CESCR-së: “Shtetet palë duhet të ndërmarrin hapa për të eliminuar “de facto” diskriminimin për shkaqet e ndaluara në ligj, ku individët apo grupet e personave nuk duhet të jenë të privuara nga mjetet apo të drejtat për të siguruar të drejtën e ujit. Shtetet palë duhet të

*sigurojnë që, shpërndarja e burimeve të ujit dhe investimet për ujin të lehtësojnë aksesin tek uji për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Duke respektuar të drejtën për ujë, Shtetet palë kanë detyrimin e posaçëm për t'u siguruar atyre që nuk kanë, ujin e pijshëm si dhe për të parandaluar çdo diskriminim për shkaqet e ndaluarra dhe të njohura në të drejtën ndërkombëtare lidhur me sigurimin e ujit të pijshëm dhe të shërbimeve të ujit”.*

Lidhur me sa mësipër, banorëve të pjesës së sipërme të rrugës “Ilir Shehu” i është mohuar e drejta e aksesit në furnizimin me ujë të pijshëm, një e drejtë e domosdoshme dhe jetike.

Bazuar në informacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe faktin që gjendja pranohet nga të dyja palët në proces, konstatohet që gjendja e këtyre banorëve vijon të mbetet e pa zgjidhur.

Nga ana e Bashkisë Elbasan dhe UKE sh.a, nuk është paraqitur asnjë provë, argument apo fakt i dokumentuar, që do të justifikojë mosmarrjen e masave efektive për sigurimin e ujit të pijshëm, në një periudhë afatshkurtër, afatmesme apo afatgjatë, duke qenë se projekti i cituar nga UKE si masë rregulluese nuk parashikon asnjë afat për realizimin e tij<sup>21</sup>.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Strukturave të Bashkisë Elbasan, duke përfshirë edhe UKE sh.a, e cila është në varësi të saj, në dëm të ankuesve, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese, pikërisht për shkak të vendbanimit të tyre.

Neni 3 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka përcaktuar se: “*Diskriminim i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1<sup>22</sup>, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se ankuesit, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e UKE sh.a dhe Bashkisë Elbasan, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me vendbanimin tyre.

## **PËR KËTO ARSYE :**

<sup>21</sup> Referuar dokumentit të pjeshëm sjellë pranë KMD-së.

<sup>22</sup>Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

- 1.** Konstatimin e diskriminimit, për shkak të vendbanimit, të banorëve të pjesës së sipërme të rrugës “Ilir Shehu”, nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a dhe Bashkisë Elbasan.
- 2.** Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a dhe Bashkisë Elbasan.
- 3.** Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a dhe Bashkia Elbasan, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
- 5.** Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Shërbime  
Shkaku: Vendbanimi